



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Administratës Publike*  
*Ministarstvo Javne Administracije - Ministry of Public Administration*

**DEPARTAMENTI PËR OJQ-DEPARTAMENT NVO-a-DEPARTMENT FOR NGOs**

<b>DATË/A:</b>	04.12.2019
<b>REFERENC-Ë:</b>	06-169/2019
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Z. Eroll Salihu, Sekretar i Përgjithshëm FFK-së
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Bajram Kosumi, Drejtor i DOJQ/MAP
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	<b>Përgjigje në Kërkesë për Interpretim</b>

I nderuar,

Referuar shkresës së pranuar nga ju me datën 02.12.2019, me të cilën keni kërkuar interpretimin e shkesës me të cilën jemi njoftuar për mbajtjen e kuvendit të jashtëzakonshëm zgjedhor, për zgjedhjen e kryetarit të Federatës së Futbollit të Kosovës, me datë 06 korrik 2018, lidhur me këtë në vijim japim këtë interpretim:

Organizatës Joqeveritare Federata e Futbollit të Kosovës, është e regjistruar me datë 200.11.2000, Nr. regjistrimit 5100477-9, OJQ-ja ka Status për Përfitim Publik Nr. 6001032-3, e kategorizuar si shoqatë sportive.

Departamenti për Organizata Joqeveritare MAP, me datë 20.08.2018 ka aprovuar kërkesën për ndryshimin e të dhënave të parashtruar nga Federata e Futbollit të Kosovës në mbështetje të nenit 9 paragrafi 4 dhe 11 par. 1 i Ligjit në 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në OJQ, për ndërrimin e përfaqësuesit të autorizuar, pozita e të cilit në organizatë është kryetari i FFK-së.



Pas shqyrtimit të kërkesës dhe analizimit të shkresave të lëndës të bashkëngjitura me kërkesë, një nga një dhe të gjitha në tersi, siç janë:

1. procesverbali nga mbledhja e kuvendit të jashtëzakonshëm zgjedhor për zgjedhjen e kryetarit të Federatës së Futbollit të Kosovës , të datë 06 korrik 2018;
2. lista e delegatëve të Kuvendit të FFK-së, prej 58 pjesëmarrës, përfaqësues sipas organizimit rajonal, në përputhje me Statutin e kësaj organizate(FFK-së) dhe
3. fotokopja e letërnjoftimit të Përfaqësuesit të autorizuar si dokumente të nevojshme për përditësimin e të dhënave në databazën e Departamentit dhe në regjistrin publik të OJQ-ve, sipas nenit 12 paragrafi 3 i Ligjit në fuçi për OJQ.

Departamenti për OJQ/MAP, ka gjetur se Kuvendi i kësaj Organizate i ka zhvilluar punimet në bazë rregullave dhe procedurave të parashikuara me Statut dhe Ligj, për zgjedhjen e përfaqësuesit të autorizuar në pajtim me parimet demokratike, pra në përputhje me dispozitat e Statutit të FFK-së si dokument më i lartë juridik i Organizatës, dhe atë neni 30, 31 paragrafi 5 dhe 7, 32, 39 dhe 52 par 4.b, i këtij Statuti dhe me depozitën e nenit 6 paragrafi 5 i Ligjit në 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në OJQ dhe se Kuvendi i FFK-së ka vendos në bazë të vullnetit autonom të delegatëve të kuvendit si organ më i lartë i OJQ-së neni 13 paragrafi 1 dhe 4.2 i Ligjit.

Në procesverbalin e bashkëngjitur të datë 06 korrik 2019 nga mbledhja e Kuvendit të Jashtëzakonshëm Zgjedhor, për zgjedhjen e kryetarit të Federatës së Futbollit të Kosovës, është evidentuar e terë procedura e zhvilluar, dhe rezulton se janë respektuar dispozitat e Statutit me rastin e organizimit dhe mbajtjes së këtij kuvendi.

Sa i përket mandatit e Përfaqësuesit të Autorizuar-pozita Kryetar i FFK-së, Departamenti për Organizata Joqeveritare në Ministrinë e Administratës Publike, duke u mbështetur në të dhënat e evidentuara në procesverbalin nga mbledhja e kuvendit të jashtëzakonshëm të FFK-së të datë 06 korrik 2018, **konfirmon si në vijim:**

Përfaqësuesi i autorizuar- kryetari i FFK-së është zgjedhur me mandat 4(katër) vjeçar, ashtu siç parashihet me nenin 39 te Statutit, nga delegatët e Kuvendi të Federatës së Futbollit të Kosovës.

Kuvendi FFK-së është i vetmi organ kompetent për zgjedhjen dhe shkarkimin e Kryetarit të Federatës së Futbollit është Kuvendi i FF-së.

Në asnjë dispozitë juridike të Statutit të Organizatës Joqeveritare të Federatës së Futbollit të Kosovës nuk parashikohet zgjedhja ndryshe e Përfaqësuesit të Autorizuar pozita e të cilit në organizatë është Kryetar FFK-së.

Ne nga Departamenti për Organizata Joqeveritare/Ministria e Administratës Publike, si organ kompetent për administrimin e politikave të regjistrimit dhe funksionimin e OJQ-ve, nuk ndërhyrë në vullnetin autonom të OJQ-ve për zgjedhjen e organeve drejtuese të tyre, madje këtë të drejtë nuk e ka asnjë institucion tjetër, nga se organizimi i brendshëm është e drejtë e pa tjetërsueshme e Organizatës



Joqeveritare, në rastin e shoqatës së FFK-së u takon anëtarëve të kuvendit të si organ më i lartë në kuadër të organizatës.

Ju falënderojmë për mirëkuptimin tuaj.